VENDIM
Nr.360, datë 13.6.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.134, DATË 18.2.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR NGRITJEN E SEKRETARIATIT TË KOMITETIT KOORDINUES TË MINISTERIALIT TË MBROJTJES SË EUROPËS JUGLINDORE (SEDM-CC) DHE TË KOMITETIT DREJTUES, POLITIKO-USHTARAK TË FORCËS PAQERUAJTËSE SHUMËKOMBËSHE TË EUROPËS JUGLINDORE (PMSC/MPFSEE) NË SHQIPËRI", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të marrëveshjes dhe të protokollit shtesë "Për krijimin e forcës shumëkombëshe të Europës Juglindore", ratifikuar me ligjin nr.8544, datë 4.11.1999, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në paragrafin e dytë të pikës 1 të vendimit nr.134, datë 18.2.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, data "... 31 korrik 2007..." të zëvendësohet me "...31 korrik 2009...".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha